iSIGURIMET

Nr. #036-37 ● Tetor-Nëntor 2022 ● www.bks-ks.com

Drejtorët e kompanive të sigurimeve mbështetën reformat në BKS 03



BIE 9.3% NUMRI I AKSIDENTEVE ME PASOJA FATALE 10

KOMPANITË E SIGURIMEVE PËR 9 MUAJ PAGUAN MBI 46 MILIONË EURO DËME

Gjatë periudhës janar-shtator, 2022 sipas të dhënave zyrtare të bankës Qendrore të Kosovës (BQK), kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në emër të dëmeve për palët e dëmtuara kanë paguar hiç më pak se 46 milionë e 553 mijë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 pagesa e dëmeve është rritur për 32,77 %.

02

Pagesa e dëmeve u rrit për 32,77 %

Gjatë periudhës janar-shtator, 2022 sipas të dhënave zyrtare të bankës Qendrore të Kosovës (BQK), kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në emër të dëmeve për palët e dëmtuara kanë paguar hiç më pak se 46 milionë e 553 mijë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 pagesa e dëmeve është rritur për 32,77 %.

iSIGURIME

Shuma të mëdha parash edhe më tutje vazhdojnë të shpenzojnë kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), për pagesën e dëmeve për palët e dëmtuara. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gati gjysma e të hyrave kanë përfunduar në pagesë të dëmeve.

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku ka thënë se çdo ditë ka progres të theksuar në pagesën e shpejtë dhe korrekte të dëmeve si nga kompanitë e sigurimeve, ashtu edhe nga Byroja Kosovare e Sigurimit. Sipas drejtorit Mazreku tashmë secila kompani, por edhe Byroja e kanë prioritet pagesën e dëmeve.

"Si asnjëherë më parë, Byroja edhe kompanitë e sigurimeve janë duke i paguar demet në kohë rekorde. Tashmë është një trend i ri i menaxhimit, ku prioritet është pagesa e dëmeve për palët e dëmtuara", ka thënë drejtori Mazreku për "iSIGURIME".

Janar-shtator 2022

Gjithnjë sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), shihet se gjatë periudhës janar - shtator 2022, janë paguar gjithsej 46,553,895 euro. Më tutje në raportin e fundit të BQK-së thuhet se numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar - shtator 2022 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është rritur për 13,121 dëme duke arritur në 123,466, nga të cilat 123,106 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 360 nga kompanitë e sigurimit të Jetës.

Janar - shtator 2021

Po ashtu edhe gjatë periudhës janar - shtator 2021, janë paguar gjithsej 45,564,093 euro dëme ose 29.95% më shumë se gjatë periudhës së njëjtë janar - shtator 2020.

Numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar - shtator 2021 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është ngritur për 20,989 dëme duke arritur në 110,345, nga të cilat 110,069 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 276 nga kompanitë e sigurimit të Jetës.

Janar – shtator 2020

Gjatë periudhës Janar - shtator 2020 janë paguar gjithsej 35,062,791 euro dëme ose 0.64% më shume se gjatë periudhës së njëjtë janar - shtator 2019. Numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar - shtator 2020 në krahasim me periudhën e njëjte të vitit paraprak është zvogëluar me 8,803 më pak dhe arriti në 89,356, nga të cilat 89,117 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 239 nga kompanitë e sigurimit të Jetës.

46,553,895€

është shuma e dëmeve që kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimit, kanë paguar gjatë periudhës janar-shtator 2022.

35,062,791€

është shuma dëmeve që kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimit, kanë paguar gjatë periudhës janar-shtator 2020.

32%

është rritur pagesa e dëmeve gjatë periudhës janar-shtator 2022 në raport me periudhën e njëjte të vitit 2020.

02 iSIGURIMET

Elsig

Telefoni: 038 221 112
Telefoni: 038 221 113
Telefoni: 038 221 114

Email: office@kselsig.com
www.kselsig.com/

Kompania e Sigurimeve "ELSIG" është themeluar në mars të vitit 2008. Periudha e dytë tremujore e vitit 2008 ka qenë periudha fillestare e investimeve në këtë kompani, ndërsa aktivitetin e vetë Kompania e Sigurimeve "ELSIG" e ka filluar nga muaji Qershor me ç'rast licencohet për shitjen e produkteve të sigurimit nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

Themelues i kësaj Kompanie është z.Agim Elshani i cili ka treguar një sukses të madh në fusha të ndryshme të afarizmit. Për z.Elshani inkuadrimi në industrinë e sigurimeve ishte një sfidë e re me barriera të mëdha, por si rezultat i punës së palodhshme suksesi ishte i pashmangshëm. Për realizimin e qëllimit të tij, z.Elshani përcaktoi objektiva të qarta dhe për këtë si objektiv kryesor ai parasheh investimin në personel. Për të punëtorët janë aset (pasuri) e ndërmarrjes dhe jo vegël e saj. Falë seriozitetit dhe profesionalizmit në lëmin e sigurimeve që kishin personeli i zgjedhur i kompanisë të cilët përpiluan strategjinë e punës, ata arritën të futen në treg dhe për një kohë shumë të shkurtër kjo kompani u mirëprit nga klientët dhe cilësohej si kompani që reflekton besueshmëri, qëndrueshmëri dhe partneritet afatgjatë me klientët e saj.

Në shtator të vitit 2008 kompania e sigurimeve Elsig bëhet anëtare e kompanisë së njohur austriake "GRAWE GROUP - Grazer Wechselseitige Versicherung Aktiengesellchaft", meqë rast u kurorëzua edhe partneriteti në mes të dy kompanive. "GRAWE Group" është kompani e cila ka traditë 180 vjeçare në fushën e sigurimeve dhe ka një shtrirje në 13 shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Anëtarësimi në "GRAWE GROUP" dhe bashkimi i kapitalit me këtë kompani, ishte objektiv tjetër i realizuar nga Kompania e Sigurimeve "ELSIG", kështuqë që nga shtatori i vitit 2008, ELSIG-u shihet si një ndër konkurentët më serioz në industrinë e sigurimeve në vendin tonë dhe me konkurrentët e saj nuk krahasohet vetëm në sferën e çmimeve, por prioritare është shërbimi cilësor i klientëve dhe cilësia e produkteve të cilat janë përgatitur me standarde të larta ndërkombëtare. ELSIG-u për një kohë shumë të shkurtër arrin të shtrihet në të gjithë territorin e Kosovës, meqë rast brenda periudhës njëvjeçare hyn në mesin e tre kompanive më të fuqishme me 13.02 % të pjesëmarrjes në treg. Vlerësim ky i bërë nga Banka Qendrore e Kosovës. Pas krijimit të stabilitetit financiar dhe profesional në vitin 2013 zt. Elshani arri të rikthej 100% të aksioneve të kompanisë në pronësinë e tij.

Në fund të vitit 2008 Kompania e Sigurimeve "ELSIG" arrin të bëjë edhe një bashkëpunim tjetër me kompaninë e sigurimit "MONDIAL Assistance Group", kompani kjo pjesë e elitës ndërkombëtare e specializuar në sferën e sigurimeve.

ELSIG-u deri më tani ka diku rreth 97 punëtorë në të gjitha nivelet dhe në tërë vendin. Investimet në këtë sferë janë të pandaluara dhe në bashkëpunim më partnerin "GRAWE GROUP" dhe "MONDIAL Assistance" shpeshherë organizohen trajnime dhe konferenca të ndryshme të produkteve të sigurimeve nëpër vende të ndryshme të Evropës qendrore dhe asaj Lindore. Kjo bëhet për arsye të aftësimit dhe të shkëmbimit të eksperiencave të ndryshme ne mes kuadrove të cilët janë pjesë e familjes se madhe "GRAWE Group".

Kompania e Sigurimeve "ELSIG" ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i autopërgjegjësisë
- Sigurimi KASKO
- Sigurimi i shëndetit në udhëtim
- Sigurimi i përgjegjësisë (publike dhe profesionale)
- Sigurimi i garancisë
- Sigurimi i pronës
- Sigurimi i aksidentit personal

Përveç angazhimit të profilit të lartë të ekspertëve në lëmin e sigurimeve ELSIG-u duke pasë parasysh së e tërë puna operative do të zhvillohet në sistemin online, ka investuar dhe do të investoj edhe më tutje në infrastrukturën moderne të Teknologjisë Informative që të sigurojë efikasitet në shërbimet dhe në veprimet e synimet e veta në të ardhmen.

Struktura organizative shpeshherë përkufizohet me komunikimin, autoritetin dhe marrëdhëniet e ndërsjella brenda organizatës. Të gjitha këto cilësi të larta organizative gjenden brenda strukturës tashmë të ndërtuar të Kompanisë së Sigurimeve "ELSIG".

10.13 % MË SHUMË TË HYRA, KRAHASIMI I VITIT 2022 ME VITIN 2021

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës gjatë periudhës janar-tetor 2022 të hyrat totale të tregut të sigurimeve kanë arritur në 104.3 milionë euro, apo 10.13 % më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga kjo shumë 55.4 milionë euro janë të hyra nga TPL-ja, 7.1 milionë euro janë të hyra nga Byroja Kosovare e Sigurimit, derisa 41.8 milionë janë të hyra nga sigurimet vullnetare.

PERIUDHA	TË HYRA TOTALE	DALLIMI %	TPL	POLICA KUFITARE	SIGURIME VULLNETARE
Janar	10.2	+24.39%	4.8	0.3	5.1
Shkurt	18.5	+15.62%	9.3	0.6	8.5
Mars	27.9	+12.95%	14.6	1.0	12.3
Prill	36.2	+13.83%	18.7	1.6	16.0
Maj	45.8	+12.53%	24.0	2.1	19.8
Qershor	58.1	+9,41%	30.8	2.6	24.7
Korrik	71.4	+10.52%	37.5	4.9	29.0
Gusht	83.1	+10.50%	44.0	6.2	32.9
Shtator	93.4	+10.66%	49.9	6.6	36.8
Tetor	104.3	+10.13%	55.4	7.1	41.8

30.21 % më shumë të hyra, krahasimi i vitit 2022 me vitin 2020

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës gjatë periudhës janar-tetor 2022 të hyrat totale të tregut të sigurimeve kanë arritur në 104.3 milionë euro, apo 30.21 % më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2020.

PERIUDHA	TË HYRA TOTALE	DALLIMI %	TPL	POLICA KUFITARE	SIGURIME VULLNETARE
Janar	8.2	+5.1%	4.5	0.3	3.4
Shkurt	16.0	-0.62%	8.9	0.7	6.5
Mars	24.7	+12.78%	13.7	1.1	9.8
Prill	31.8	+20.45%	17.0	1.6	13.2
Maj	40.7	+19.00%	22.1	2.2	16.4
Qershor	53.1	+18.79%	29.1	2.8	21.2
Korrik	64.6	+20.29%	35.8	4.3	24.6
Gusht	75.2	+19.36%	42.0	5.3	28.0
Shtator	84.4	+18.20%	47.8	5.7	31.2
Tetor	94.7	+18.22%	53.0	6.1	35.6

NË PRILL SHITJA E POLICAVE U RRIT PËR 23,50 %

Gjatë pjesës së dytë të muajit mars, kohë kur ka filluar ngjitja e stikersave në xhama të automjeteve, si dhe gjatë muajit prill të këtij viti ka pasur rritje të shitjes së policave deri në 23,50 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Se vendosja e stikersave ka ulur numrin e automjeteve të paregjistruara në vend ketë e kanë konfirmuar nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), si dhe Institucionet tjera të vendit.

Vendosja e stikersave në xhama të automjeteve ka ndikuar edhe në uljen e numrit të automjeteve të paregjistruara në vendin tonë. Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), shihet se gjatë pjesës së dytë të muajit mars, kohë kur ka filluar ngjitja e stikersave në xhama të automjeteve si dhe gjatë muajit prill të këtij viti ka pasur rritje të shitjes së policave deri në 23,50 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Se vendosja e stikersave ka ndikuar dukshëm në uljen e numrit të automjeteve të paregjistruara në vendin tonë e ka konfirmuar drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku, si dhe përfaqësues tjerë të Institucioneve të vendit që merren më ketë fushë.

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të BQK-së, shihet se në muajin mars 2022 në raport me muajin e njëjtë të vitit paraprak shitja e policave është rritur për 12,80 %, në muajin prill 2022 në raport me muajin prill 2021 shitja e policave është rritur për 23,50 %.

Po ashtu edhe gjatë muajit maj shitja e policave është rritur për 3,9 % në raport me muajin maj të vitit paraprak. Derisa muajin e fundit të raportimeve, shtator 2022, shitja e policave është më e lartë për 3,1 % në raport me atë të muajit shtator të vitit paraprak.

> “Në muajin mars 2022 në raport me muajin e njëjtë të vitit paraprak shitja e policave është rritur për 12,80 për qind, në muajin prill 2022 në raport me muajin prill 2021 shitja e policave është rritur për 23,50 për qind”
>
> **THUHET NË RAPORTIN E BQK-SË**

Muaji	2021	2022	Krahasimi 2022/2021
Janar	28,343	30,924	+9,1 %
Shkurt	26,321	28,000	+ 6,3 %
Mars	27,286	30,779	+ 12,80 %
Prill	18,953	23,408	+23,50 %
Maj	30,840	32,060	+ 3,9 %
Qershor	42,680	42,618	- 0,1 %
Korrik	40,896	41,884	+ 2,4 %
Gusht	39,919	42,498	+ 6,4 %
Shtator	36,914	38,080	+ 3.1 %
Tetor	32,493	/	
Nëntor	35,885	/	
Dhjetor	36,098	/	

Eurosig

Telefoni: 038 244 080 **email: info@eurosig-ks.com**
Telefoni: 038 244 081 **www.eurosig-ks.com**

Eurosig themeluar si Kompani Sigurimesh në aktivitetin e Jo – Jetës që nga i vitit 2000 fillimisht me emrin Dardania dhe duke filluar nga dhjetori i vitit 2015 del në treg me emrin e ri Eurosig sh.a., tërësisht me kapital dhe aksionerë shqiptarë. Veprimtaria e kompanisë rregullohet në bazë e në zbatim të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tyre, si dhe mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës, Departamenti për Mbikqyrjen e Sigurimeve.

Eurosig, si kompani e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me 8 degë dhe mbi 62 zyre përfaqësimi. Zgjerimi i rrjetit të shitjes, pozicionimi në tregun e sigurimeve me një rritje të ndjeshme dhe relativisht të shpejtë, ka ardhur si rezultat i një pune të vazhdueshme dhe i një stafi të kualifikuar të saj.

Eurosig tanimë klasifikohet si kompania me rendimentin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve në Kosovë por edhe në Shqipëri. Eurosig ofron zgjidhje të përshtatshme të sigurimit që zhvillohen në një botë në ndryshim dhe për këtë qëllim ka në dispozicion personel të aftë e profesionist, dinamik dhe kompetentë të vërtetë. Ata janë të vëmendshëm ndaj kërkesave tuaja, dinë se çfarë është produkti më favorit për ju, ndaj dhe do të ju ofrojnë këshillat e mundësitë më të mira.

Nëpërmjet Eurosig ju mund të siguroni automjetin, banesën apo shtëpinë, shëndetin, përgjegjësinë publike dhe profesionale, dhe shumë sigurime të tjera. Sot, në sajë të një strategjie të integruar të ofertave dhe një modeli unik e inovativ, ju do të jeni në duar të sigurta që do të thotë: besueshmëri, siguri janë gurët e themelit të filozofisë së Eurosig.

MISIONI I KOMPANISË

Eurosig, gjithmonë me një profil të qartë, ofron shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjërë. Ne do të vazhdojmë të punojmë për të forcuar identitetin tonë, duke ofruar gjithmonë shërbime sa më korrekte, për të krijuar një imazh sa më të konsoliduar në tregun e sigurimeve, mbi bazat e një biznesi të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt kërkesave të klientit.

Eurosig, në tregun e sigurimeve, me një staf të kualifikuar dhe me përvojë e eksperiencë të gjatë pune, do të vazhdojë të japë një garanci të plotë financiare ndaj çdo rreziku, i çfarëdo lloji qoftë.Ne jemi gjithnjë të angazhuar që Eurosig të jetë sa më tërheqës në tregun e sigurimeve, nëpërmjet rritjes së cilësisë dhe garantimit të një shërbimi të shpejtë, efikas dhe profesional ndaj klientëve, duke ofruar çmime konkuruese në rrjetin e saj të shpërndarë në të gjithë vendin.. Shërbimi ynë do të tejkalojë kërkesat e klientëve. Kjo do të arrihet nëpërmjet planifikimit strategjik, duke synuar rritjen e qëndrueshme të kompanisë, struktura fleksibël, rritjen e imazhit në publik, duke qenë sa më pranë njerëzve në situatat e vështira, për rimbursimin maksimal të dëmeve që atyre mund të ju shkaktohen.

Duke vlerësuar kapacitetet profesionale të të punësuarve tanë si një avantazh për të ndërtuar rrugët konkurruese, duke u mbështetur në të ardhurat dhe burimet financiare që kjo shoqëri ka, në angazhimin maksimal të çdo individi , të shpirtit të inovacionit dhe përsosmërisë së tyre, nëpërmjet kryerjes së investimeve të reja synojmë modernizimin e gjithë veprimtarisë së kompanisë dhe informatizimin e sistemit të saj sipas standardeve bashkëkohore, duke krijuar lehtësimet e domosdoshme të komunikimit me klientët tanë për të ju gjendur pranë në kohën dhe rrugën më të shpejtë të mundshme.

Kompania e Sigurimeve "EUROSIG"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i shëndetit
- Sigurimi i shëndetit në udhëtim
- Sigurimi i pasurisë
- Sigurimi i automjetit
- Sigurimi Shtëpiak
- Sigurimi nga aksidentit personal

VIZIONI I KOMPANISË

Grup kombëtar, me standarde europiane, që prodhon rezultate të shkëlqyera, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara. Është një kompani serioze në mardhënie me klientët, mirëpret çdo kërkesë të bërë nga ana e tyre dhe ju qëndron pranë deri në zgjidhjen e plotë të problemeve. Në fokus të të gjithë punëve e aktiviteteve që kryen kompania, primare ka qenë dhe mbetet shërbimi ndaj klientëve, shërbim i cili kryhet nga një personel i kualifikuar dhe me vizion të qartë në punë. Ne para klientëve jemi gjithnjë në provë, të cilën e vërtetojmë dhe argumentojmë me punën tonë.

Dukagjini

Telefoni: 048 750 005 email: info@dukagjiniks.com
www.dukagjiniks.com

Po rikthehet sërish “Dukagjini”, Kompania e sigurimeve që e çmonit dhe i besonit më së shumti!

Po vjen kësaj here më e vendosur dhe më e motivuar se kurrë për t’ju ofruar shërbimet më cilësore në fushën e sigurimeve, për të cilat keni qenë të bindur sa herë. Po inkuadrohet tash e tutje në tregun kosovar të sigurimeve adresa të cilës më së shumti i drejtoheshit, duke ruajtur cilësitë që i keni njohur dhe i njihni, shërbimet e shpejta, efikase, afarizmin profesional, sigurinë në mbulimin e dëmeve dhe bashkëpunimin e suksesshëm me partnerët afaristë.

20 VITE EKSPERIENCË

Kësaj here kemi marrë mbi vete dhe kompaninë në zë “Croatia” për të bërë bashkë dy përvoja më se të vlerësuara në këtë treg, që tash e tutje do të shfaqen me emrin e “Dukagjinit”.

CILËSI TË VJETRA LIDHJE TË REJA

Ju do të rinjihni cilësitë e vjetra, do të çmoni lidhjet e reja, të sigurta, dhe do t’i mbështeteni një perspektive premtuese, të ngritur mbi themelet e vjetra dhe solide të emrit më të besuar në këto anë.

Adresë e saktë dhe e sigurt, “Dukagjini”, ofron shërbimet për klientët e vet të vjetër dhe për klientët e rinj që duan efikasitet dhe garanci, për klientët e “Croatia sigurimit” që do të binden në kontinuitetin dhe autoritetin që ofron për ta kompania e re, ajo që tashmë e ka marrë çdo gjë në duar të sigurta.

Andaj, ju lutemi, të dashur miq, afaristë, partnerë, qytetarë, mos nguroni dhe na kontaktoni në adresat tona të reja, ku do të ndeshni një pjesë të stafit që e keni njohur, i keni besuar dhe i cili ju ka ofruar gjithnjë shërbimet më cilësore, merrni informatat që ju nevojitet dhe binduni – një erë e re fryn në fushën e sigurimeve në Kosovë, një erë që sjell shpresë dhe begati për një jetë më të mirë!

Atë ua garantojmë ne dhe ju premtojmë se do të vazhdojmë të jemi gjithnjë pranë jush!

SIGURIMI KASKO KOMODITET I PLOTË

Ne do të kompensojmë, brenda vetëm disa ditësh, të gjitha dëmet në automjetin tuaj në qoftë se ka ndodhur gjatë dhe / ose të qëndrimit në Kosovë, por në rast të kërkesës tuaj, ne do të ju mundësojm sigurim të jetë i vlefshëm për territorin e shteteve të rajonit (EJL – Evropës Juglindore) si dhe mbarë Bashkimin Evropian. Me këtë sigurim mbulohen dëmet e shkaktuara në automjetin tuaj bazuar në kushtet e përgjithshme për sigurimin kasko të plotë. Mbulesat siguruese janë paraqitur në detaje si dhe përjashtimet, pjesa e zbritshme dhe/apo franshiza.

Për çdo sqarim ju lutemi mos hezitoni të na pyetni neve sepse sigurisht se do ta keni informatën më të plotë me rastin e përzgjedhjes së produktit kasko të disejnuar sipas përzgjedhjes tuaj.

PËR NJË SHËNDET MË TË MIRË

Hospitalizimin - i cili konsiderohet, trajtimet për shtrimin e nevojshëm spitalor në institucionet shëndetësore të miratuara për këto qëllime, të cilat parashikojnë një qëndrim fizik për këto mjekime/kurime, të paktën 24 orësh, që kanë mundësi diagnostikuese dhe terapie, që veprojnë në përputhje me standardet e përgjithshme të mjekësisë.

Nuk janë të kufizuara në përdorimin e metodave dhe trajtimeve speciale, dhe të cilat mbajnë historikun e sëmundjes apo/dhe trajtimit.

UDHËTONI LIRËSHEM SEPSE SHTËPINË E KENI NË DUAR TË SIGURTA

Mbrojtja e pasurisë tuaj, shtëpisë apo banesës si dhe pajisjeve, gjësendeve tuaja do të thotë siguri dhe mbrojtje financiare në rast të dëmit, respektivisht kompenzim financiar për dëmtimet fizike në pronën tuaj dhe rikthim në gjendjen paraprake të pronës deri në maksimumin e paraparë me kushtet e përgjithshme nga plani i juaj i sigurimit të pronë.

GJATË KOHËS SË QËNDRIMIT JASHTË VENDIT

Sigurimi i shëndetit në udhëtim do të ju mbulojë sigurimin e shëndetit gjatë qëndrimit tuaj jashtë vendit në rast të ndonjë sëmundje si dhe do të mbulojë maksimalisht deri në limitin e sigurimit tuaj.

Për disa vende të cilat ju planifikoni ti vizitoni sigurimi i shëndetit është i doemosdoshëm andaj Dukagjini ka ofertën më të mirë për ju

BKS-ja shënoi 11 vjetorin e themelimit

Në një ceremoni ku ishin të pranishëm zyrtarë të lartë, por edhe ndërkombëtarë, Byroja Kosovare e Sigurimit ka shënuar 11 vjetorin e themelimit. Drejtori i BKS-së Sami Mazreku ka thënë se gjatë 2 viteve si drejtor i BKS-së plotësuan të gjitha kriteret teknike për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.

iSIGURIME

Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) në një ceremoni solemne ka shënuar 11-vjetorin e themelimit, ku të pranishëm në një organizim të shkëlqyeshëm ishin zyrtarë të lartë të vendit, nga rajoni, por edhe Brukseli.

Drejtori i Byrosë Sami Mazreku, ka paraqitur para mysafirëve të arriturat gjatë dy vjetëve sa udhëheq me këtë Institucion shumë të rëndësishëm.

Ai tha se në këtë fazë kanë bërë korrigjimin e të metave të viteve të kaluara, duke eliminuar çdo ndikim të mundshëm politik dhe ndryshuar imazhin e Byrosë.

Në vitin 2020 sipas tij, ndodhi mrekullia ngase kompanitë e sigurimeve e mbyllën vitin me bilanc pozitiv.

12 MIJË DOSJE TË MBYLLURA

Sipas tij, janë përfunduar 12 mijë dosje dhe janë grumbulluar 1 milion euro në emër të dëmeve nga automjetet. Ai shtoi se numri i automjeteve të paregjistruara ka arritur në 4.5 dhe se janë plotësuar kushtet për anëtarësim në Këshillin e Byrove.

“Korrigjuam të metat që kam gjetur në këtë institucion të krijuar 11 vjet më parë. Eliminuam çdo ndikim të mundshëm politik. Në vitin 2020 te ne ndodhi mrekullia, kompanitë e mbyllën vitin me bilanc pozitiv. Ndryshuam imazhin e BKS-së. arritëm të mbyllim 12 mijë dosje. Në emër të dëmeve nga automjetet inkasuam 1 milion euro”.

“Nënshkruam marrëveshjen me Malin e Zi për njohjen e policave. Arritëm në 4.5% te automjeteve te paregjistruara. Tashme byroja e sigurimit ka plotësuar kushtet të jetë pjesë e Këshillit të Byrove. Po shpresojmë që me ndihëm tuaj edhe qytetarët do të lëvizin lirshëm”.

PËRMES STIKERSAVE U ZVOGËLUA NUMRI AKSIDENTEVE

Zëvendëskryeministrja, Emilja Rexhepi, tha se vendosja e stikerasve ka bërë që të zvogëlohet numri i aksidenteve. “Ne si Qeveri i përcjellim reformat e këtij institucioni dhe mbështesim çdo mundësi bashkëpunimi që të sigurojmë liri të lëvizjes”.

Greet Flore, nga Këshilli i Byrosë të Sigurimit në Bruksel, tha se janë bërë shumë ndryshime në këto 11 vjet nga Byroja Kosovare e Sigurimeve.

Ajo ka folur për anëtarësimin e Kosovës në Këshill, duke përmendur faktin e mosnjohjes së targave nga shumë vende duke e cilësuar këtë si çështje politike.

“Ka pengesa e sfida, sepse Kosova është pjesërisht i njohur, sepse tabelat e Kosovës nuk njihen nga të gjithë. Këto janë kushtet për t’u bërë pjesë e Këshillit të Byrove. Kemi menduar për një zgjidhje. Një vend tjetër do të ofrojë polisa që të mund të lëvizin qytetarët lirshëm”.

LËSHIMI I KARTONIT TË GJELBËR ËSHTË NJË MUNDËSI

“Katroni i gjelbër është iniciuar nga Kombet e Bashkuara sepse jemi shumë të lidhur me ta. Ne do të ishim të lumtur sikur ta lehtësonim jetën tuaj më shumë. Ne jemi të bllokuar nga shumë çështje politike. Ne do të punojmë për të gjetur zgjidhje”.

Kurse presidentja e Këshillit të Byrosë, Sandra Shëarz, tha se ndonëse ditë feste për Byronë nuk mund të jap lajmin për anëtarësim në Këshill.

Ajo ka përmendur një varg pengesash duke e cilësuar këtë proces si jo të lehtë, por që ka premtuar zgjidhje të shpejtë, raporton EO.

“Është hera e parë që jam këtu. Ne fatkeqësisht nuk po ua sjellim mesazhin që po vuani për të dhe nuk mund t’ju them sot se do të bëheni anëtarë të organizatës së byrove. Natyrisht janë dy pengesa ende para nesh. Edhe po të ishte aq lehtë do ta bënim në të kaluarën”.

“Lëshimi i kartonit të gjelbër është një mundësi, por ju po e shihni se kemi bërë rregullat tona dhe nevojitet një shtet anëtar që lëshon kartoni të gjelbër. Problemi i parë është termi shtet. Ne kemi një boshllëk në mes të Evropës dhe dëshirojmë ta kalojmë këtë situatë. Kartoni e gjelbër e mbulon trafikun, por kemi shumë vizitorë nga jashtë. Nëse keni karton të gjelbër mund të dilni, por pa e pasur sigurimin në pika kufitare, ata që vijnë nga jashtë nuk mund të hyjnë. Duhet të negocioni të gjeni zgjidhje”.

SIGURIMET NË NUMRA

9,530,567€
është rritur volumi i primeve të shkruara bruto gjatë periudhës janar-gusht 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

12.2%
është rritur tregu i sigurimeve gjatë periudhës janar-gusht 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

87,529,859 €
ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto, në fund të muajit gusht të këtij viti.

9,593
dëme më shumë janë paguar gjatë periudhës janar-gusht 2022, sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

909,320
ka arritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit gusht të këtij viti.

12.8%
është rritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit gusht të këtij viti, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

109,648
dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve, por edhe nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, vetëm gjatë periudhës janar-gusht 2022.

83,102,221€
ka arritur volimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit gusht të këtij viti.

10.66%
është rritur volimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit gusht të këtij viti.

4,427,632€
ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës, deri në fund të muajit gusht të këtij viti.

52.42%
është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës deri në fund të muajit gusht të këtij viti, në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

25,184
ka arritur numri i kontratave në sigurimin e jetës, në fund të muajit gusht të këtij viti.

48.13%
është rritur numri i kontratave në sigurimin e jetës gjatë periudhës janar-gusht 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Performanca e sektorit të sigurimeve gjatë periudhës janar-gusht 2022 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak .

dukagjini insurance company · EUROSIG Kompani Sigurimesh · ELSIG · SIGURIA · ILLYRIA · SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA · SIGMA Vienna Insurance Group · SCARDIAN · PRISIG · SIGKOS

dukagjini insurance company · EUROSIG Kompani Sigurimesh · ELSIG · SIGURIA · ILLYRIA · SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA · SIGMA Vienna Insurance Group · SCARDIAN · PRISIG · SIGKOS

BKS
Byroja Kosovare e Sigurimit
Kosovski Ured Osiguranja
Kosovo Insurance Bureau

Art. 5.1.1. AoA: « ...must co with...[acting in] a state that is
member of the United Natio »
Impossible under the s and circumstances
BKS
Byroja Kosovare e Sigurimit
Kosovski Ured Osiguranja
Kosovo Insurance Bureau

Most unlikely that the GC system would have been set up wit
this initiative
COB is working under the a of the United Nations (UN-EC
and reports yearly on its
BKS
Byroja Kosovare e Sigurimit
Kosovski Ured Osiguranja
Kosovo Insurance Bureau

BKS
Byroja Kosovare e Sigurimit
Kosovski Ured Osiguranja
Kosovo Insurance Bureau

SIGKOS

Telefoni: 038 614 614 email: info@sigkos.com
www.sigkos.com

Aktiviteti afarist i Kompanisë së Sigurimeve SIGKOS do te mbeshtetet ne sherbime kompetente dhe profesionale te sigurimeve, në azhuritetin dhe diciplinen në punë, në rrespektin dhe përkrahjen për nevojat e klientit dhe në përmbushjen strikte të obligimeve tona në relacion (raport) me klientin pa e dalluar atë ne bazë të vëllimit të kërkesave dhe potencialit te tij.

Për të arritur që ta permbushim nivelin e shërbimeve tona ndaj klientit, menaxhmenti i Kompanisë së Sigurimeve SIGKOS ka paraparë:

– Organizimin e aktivitetit të Kompanisë në 7 qendrat kryersore në Kosovë
– Programe të trajnimit të personelit që do të jetë bartës i shërbimeve për klientët dhe
– Mbrojtje profesionale për klientet

PROGRAMI I TRAJNIMIT TË PËRSONELIT

Menaxhmenti i Kompanisë së Sigurimeve SIGKOS ka paraparë një program vuliminoz për tërë vitin afarist per trajnimin e personelit, i cili do të bartë, rrespektivisht oforojë shërbime për klientët e SIGKOS-it.

Programi i trajnimit perfshin module të ndryshme duke filluar nga trajnimi i personelit se si duhet të sillet me klientin, si duhet të jetë efikas dhe deri te moduli i trajnimi për këshilla profesionale për mënyrën e prezentimit dhe shitjes së produktit të sigurimit. Personeli i KS SIGKOS do të jetë permanent i gatshëm për çfarëdo këshille lidhur me produktet e sigurimeve për klientët e interesuar.

STAFI- MENAXHMENTI I KS SIGKOS

KS SIGKOS ka komponuar një staf mirë të shkolluar në aspektin profesional dhe përvoja e tyre e punës vjen në rend të parë nga puna profesionale që kanë berë në vendet e zhvilluar të perëndimit.

MBROJTJA PROFESIONALE PËR KLIENTIN

Menaxhmenti i KS SIGKOS ka paraparë edhe organizimin e ofrimit të shërbimeve për klientet e vetë, duke i mbrojtur ata pa shenzime shtesë dhe në menyrën më të mirë profesionale për kontestet që dalin nga efekte që ka kontrata- polica e sigurimit.

Mbrojtja juridike për klientët do të organizohet duke ju ofruar policen e sigurimit për marrjen e shpenzimeve ligjore për kontestet që dalin nga efektet e policës së sigurimit.

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS ËSHTË E THEMELUAR NGA DY AKSIONAR:

Zt. Hashim Deshishku dhe
Zt. Milazim Zeqiraj

Të dy aksionarët e KS SIGKOS janë afarist të njohur për ekonominë e Kosovës dhe gëzojne një imazh shumë të mirë me bizneset e tyre.

Zt. Hashim Deshishku është pronar i Kompanisë LESNA ndërsa,

Zt. Milazim Zeqiraj është pronar i KompanisëMCM

Kompania e Sigurimeve "EUROSIG"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i mjeteve motorike
- Sigurimi Kasko
- Sigurimi i Aksidentit Personal
- Sigurimi i Garancioneve
- Sigurimi i Pasurisë
- Sigurimi i Përgjegjësive
- Sigurimi i Objekteve në Ndërtim
- Sigurimi i Objekteve në Montim
- Sigurimi i Parave ne Kasaforte (CIS) dhe transit (CIT)

Të dy aksionarët e KS SIGKOS janë themeluesit dhe aksionarët kryesor në Banken komerciale KASABANK.

Suksesi në bizneset e aksionarëve të KS SIGKOS është garantues për krijimin e mirëbesimit për klientët e KS SIGKOS që është bazë e filozofisë së afarizmit të sigurimeve për të qenë i sukseshem.

Siguria

Telefoni: 038 600 848
049 777 012

email: info@ks-siguria.com
www.ks-siguria.com

Suksesi i kompanisë tonë matet me rritjen të numrit të klientëve tanë i cili sa vjen e shtohet, gjithashtu e pashmangshme është edhe rritja e besimit të klientëve tanë gjë që na mundëson edhe rritjen e kualitetit të ofertave tona dhe të detyrimeve që dalin nga sigurimet.

Besimi i klientit në aftësinë tonë për të përmbushur detyrimet tona në çdo kohë, përbën bazën e suksesit tonë. Dinamizmi është fenomeni kryesorë që përshkruan Siguria në aspektin e shërbimit të klientit. Kompania e jonë ka punuar vazhdimisht që proceset e klientëve të saj të jenë sa më efikas dhe më të shpejtë, duke përfshirë modernizimin dhe optimizimin e të gjitha proçeseve, si dhe duke ofruar shërbime shumë cilësore.

Kompania e Sigurimeve SIGURIA, gjatë rrugës drejt krijimit te identifikimit të saj, por edhe më vonë gjatë tërë kohës pati përkrahjen e pakufishme prej partnerëve të saj, të cilët e përkrahën shumë dhe pa të cilët vështirë se do të mund të arrihej ky stad i zhvillimit të kompanisë.

Kompania e Sigurimeve Siguria njihet me shërbimin më kualitativ në industrinë e sigurimeve. Këtë shërbim e ofrojmë përmes paketave të produkteve për klientët, të cilët mund të zgjedhin ofertën me nivelin optimal financiar dhe duke e bazuar atë në kërkesat e tyre specifike. Siguria synon të jetë partneri më i besueshëm për klientët dhe të sigurojë mbulimin maksimal të tregut të sigurimeve. Siguria synon të jete gjithmonë në një proçes drejt risive dhe inovacioneve të reja.

Kompania e Sigurimeve SIGURIA është krijuar me datën 05.06.2000 si organizatë me përgjegjësi të kufizuar, bazuar në ligjin mbi sigurimin e përkohshëm të shoqërive tregtare (UNMIK Reg.2000/8 dt. 29.02.2000).

Kompania në fillesat e saj startoj me sigurimet që njiheshin në tregun tone si sigurime të detyrueshme dhe gradualisht, solli risi në tregun tone duke e freskuar atë me sigurime të reja vullnetare krahas kompanive të tjera evropiane.

– Sigurimi i përgjegjësisë publike, etj.

Kurse ne si kompani e sigurimeve u munduam që të sjellim tek ju të gjitha produktet për të krijuar siguri më të madhe, për ju.

Si kompani e sigurimeve kemi përmbushur me shumë sukses të gjitha obligimet tona financiare si dhe kurrë nuk i jemi shmangur ligjit të aprovuar nga BPK për sigurime, që shërben si bazament i të gjitha veprimeve tona të mëtutjeshme.

Portofolin tonë e kemi ri siguruar nga ri siguruesit të lartë për të qenë edhe më të sigurte se do ti përmbushim obligimet tona ndaj jush.

Sot tregu ynë mbulon tërë Kosovën me të gjitha qendrat e saj me intencë të rritjes së veprimtarisë dhe jashtë kufijve të vet.

Kompania e Sigurimeve Siguria ofron shumë produkte sigurimi larmishme që e lejon atë të kujdeset për një numër të madh konsumatorësh. Produktet dhe shërbimet ofrohen përmes një rrjeti të gjerë të stafi të shitjesh, agjentësh dhe partnerëve ekskluzivë në të gjithë territorin e Kosovës.

Në këtë kompani janë të punësuar rreth 80 punojës në zyrë si dhe rreth 150 agjentë që veprojnë në kuadër të “Kompanisë së Sigurimit SIGURIA”

Kompania e Sigurimeve "Siguria"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i Pronës
- Sigurimi i Shëndetit
- Aksidentet Personale
- Sigurimi i Shtëpisë/Banesës
- Sigurimi i Rreziqeve në Ndërtim
- Sigurimi i Garancionit
- Sigurimi Kasko
- Sigurimi i Autopërgjegjësisë
- Shëndeti në Udhëtim
- Sigurimi i Parave
- Sigurimi i Mallit në Transport

dukagjini EUROSIG ELSIG SIGURIA ILLYRIA SIGAL UNIQA SIGMA SCARDIAN PRISIG SIGKOS

Mazreku: Përmes zvogëluam numr

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) Sami Mazreku ka thënë se përmes kampanjave të shumta që ka organizuar BKS-ja ka ndikuar në uljen e numrit të aksidenteve në vendin tonë. Sipas tij, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak jemi rreth 250 aksidente më pak.

iSIGURIME

Kampanjat e shumta të organizuara nga Byroja Kosovare e Sigurimit kanë ndikuar në uljen e numrit të aksidenteve si të atyre më lëndime, ashtu edhe të atyre me pasoja fatale. Këto komente drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) Sami Mazreku i ka bërë gjatë hapjes së fushatës "Përkujto, Mbështet, Vepro" në kuadër të javës për shënimin e Ditës botërore të përkujtimit të viktimave në trafikun rrugor e organizuar nga Asociacioni Kosovar i Motorizimit (AMRKS) dhe Akademia "Tempulli", si dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve (BSK).

192 PERSONA KANË HUMBUR JETËN

Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hisen Durmishi, tha se aksidentet rrugore janë shkaku kryesor i vdekjeve, duke shtuar se nga viti 2020 deri në vitin 2021 kanë humbur jetën 192 persona në aksidente.

Prandaj ai ka bërë apel te pjesëmarrësit në trafik të kenë pajisje të domosdoshme dhe të përshtaten me kushtet e rrugës e t'i respektojë rregullat a trafikut.

"Çdo vit më shumë se 1.3 milion njerëz vdesin në gjithë botën. Kostot janë 1 deri 3% të bruto produktit vendor. Aksidentet paraqiten si problem multi-displinar. Për një vit kanë humbur jetën 192 persona dhe është shifër mjaft shqetësuese, dhe ju shpreh ngushëllime njerëzve që kanë humbur më të dashurit e tyre". "Ne jemi duke bërë investime dhe angazhim bashkë me Policinë dhe akterë të tjerë që të kontribuojnë që të ulet numri i aksidenteve. Si ministri jemi duke investuar në çështjen e sigurisë rrugore. Secili prej nesh jemi përgjegjës për sigurinë tonë. Edhe këtë vit po shënojmë aktivitet që vitet tjera të kemi sa më pak aksidente rrugore. Drejtësi për të gjithë ata që kanë humbur jetën në aksidentin rrugor. Ftoj të gjithë pjesëmarrësit në trafik të kenë pajisje të domosdoshme në trafik".

250 AKSIDENTE MË PAK

Po ashtu edhe drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Sami Mazreku, tha se do ta përmbushin obligimin që kanë që të gjitha viktimat të përfitojnë nga kompensimi i dëmeve.

Sipas tij, vendosja e stikerëve për veturat e regjistruara, por edhe kampanjat e shumta që ka organizuar gjatë vitit BKS-ja kanë ndikuar që të zvogëlohet numri i aksidenteve për 250 më pak. "Është shqetësuese rritja e numrit të rasteve me lëndime të lehta. Është me rëndësi të theksohet një projekt vendosja e stikerave e ka rritur sigurinë në trafikun rrugor. 250 aksidente më pak kemi tani dhe siguri me të lartë. Ne përkrahim këtë kampanjë dhe jemi pjesë e saj".

POLICIA PËRKRAH AKTIVITETET

Jeton Rexhepi, nënkolonel në Policinë e Kosovës, tha se çdo vit kanë përkrahur aktivitet në shënimin e përkujtimit të viktimave në trafikun rrugor. Ai ka bërë të ditur se nga e marta hyjnë në fuqi masat e sezonit dimëror, ka raportuar EO. "Ne kemi fushata senzibilizuese në terren nga sot deri të dielën. Kjo ditë është përkujtues i rëndësishëm për ne dhe për pjesëmarrësit në trafik. Do të ketë prezencë të shtuar në terren dhe fillojmë me masa të reja për sezonin dimëror". "Këtë vit po shënojmë me pak viktima në trafikun rrugor, me 9 viktima më pak dhe rënie të aksidenteve me dëme materiale. Për 3.7 % kemi rritje të aksidenteve me lëndime. Apelojmë që të gjithë njerëzit në trafik të kenë kujdes të shtuar në respektim të rregullave".

Muhamed Krasniqi, nga Asociacioni Kosovar i Motorizimit (AMKRS), tha se shumë aksidente mbesin pa u hetuar dhe nuk zbatohet legjislacioni i fushës.

Prandaj sipas tij, sistemi i drejtësisë me hetim të plotë do të ishte faktor kryesor për parandalimin e aksidenteve, raporton EO. "Në këtë ditë kujtojmë ata që kanë rënë në trafikun rrugor dhe bëjmë thirrje qeverisë të parandalojnë këto tragjedi në rrugë. 10 viktima në Kosovë i shtohen 50 milionë të vdekurve". "Ne kaluam pandeminë, por akoma jemi duke e përjetuar një pandemi në aksidentet rrugore. Shumë aksidente mbesin pa u hetuar dhe nuk zbatohet legjislacioni i fushës. Sistemi i drejtësisë me hetim të plotë do të ishte faktor kryesor për parandalimin e aksidenteve". Gjatë javës janë paraparë një varg aktivitetesh në shënim të kësaj dite dhe sipas organizatorëve objektivat e kësaj ngjarje janë të sigurojnë një platformë për mbështetjen e viktimave të trafikut rrugor dhe familjet e tyre.

dukagjini EUROSIG ELSIG SIGURIA ILLYRIA SIGAL UNIQA SIGMA SCARDIAN PRISIG SIGKOS

dukagjini · EUROSIG · ELSIG · SIGURIA · ILLYRIA · SIGAL UNIQA · SIGMA · SCARDIAN · PRISIG · SIGKOS

s kampanjave
in e aksidenteve

dukagjini · EUROSIG · ELSIG · SIGURIA · ILLYRIA · SIGAL UNIQA · SIGMA · SCARDIAN · PRISIG · SIGKOS

SIGAL
UNIQA GROUP AUSTRIA

Telefoni: 038 240 241 **email: info@uniqa-ks.com**
www.uniqa-ks.com

SIGAL Sh.a u themelua me 22 Shkurt 1999 menjëherë pas liberalizimit të tregut të sigurimeve në Shqipëri. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është kompania e më e madhe e sigurimeve në Shqipëri nën strukturën e së cilës ushtrojnë aktivitetin e tyre sigurues 8 kompani të suksesshme sigurimi: SIGAL UNIQA (Shqipëri, Jo-Jetë), SIGAL Life UNIQA (Shqipëri, Jetë), SIGAL UNIQA Kosova (Kosovë, Jo-jetë), SIGAL Life UNIQA Kosova (Kosovë, Jetë), UNIQA a.d Shkup (Maqedoni, Jo-jetë), UNIQA Life a.d (Maqedoni, Jetë), SIGAL Risigurime dhe Fondi i Pensioneve Private SIGAL. Rrjeti i SIGAL UNIQA ka mbi 1,100 punonjës dhe agjentë të cilët ofrojnë shërbim cilësor dhe në kohë për mbi 500,000 klientë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Sigal Uniqa sponsor gjeneral i Superligës së femrave

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Federata e Futbollit e Kosovës, sot, ka nënshkruar edhe një marrëveshje të re bashkëpunimi tejet me rëndësi. Kompania e sigurimeve "Sigal Uniqua Group Austria", e cila tash e një kohë është partnere e FFK-së, do të jetë zyrtarisht sponsor gjeneral i Superligës së femrave në futbollin kosovar dhe nga sot e tutje kjo ligë do të emërtohet Sigal Superliga e femrave.

Marrëveshjen e sponsorizimit e nënshkruan presidenti Agim Ademit dhe drejtori i përgjithshëm i kompanisë Sigal Uniqa Group Austria, Avni Ponari.

Futbolli i femrave është një nga prioritetet kryesore të këtij katërvjeçari të presidentit Ademi, andaj do të punohet në vazhdimësi për krijimin e kushteve sa më të mira dhe përkrahja dhe përkushtimi nuk do të mungojë.

Nga ana tjetër edhe drejtori i Sigal-it, Avni Ponari u shpreh i lumtur për mundësinë e bashkëpunimit me FFK-në dhe për kontributin që kjo kompani do ta jepë në zhvillimin e futbollit të femrave në vendin tonë.

Që prej disa vjetësh, jemi sponsor të skuadrave të ndryshme të basketbollit dhe futbollit përfshirë mbështetjen ndaj Federatës Shqiptare të Basketbollit. Një ndër skuadrat e mbështetura nga SIGAL UNIQA në Kosovë, SIGAL Prishtina është prej disa vitesh skuadër kampione. Përgjatë viteve kemi mbështetur zhanre të ndryshme sportive ndër të cilat sportet ujore, garat me makina dhe alpinizmin (ekspedita shqiptare në malin Everest, ekspedita kosovare në malin Kaçkalar, Turqi).

Sloganin tonë 'Shëndeti vjen i pari' e aplikojmë jo vetëm në ofrimin e paketave të sigurimit shëndetësor por edhe duke mbështetur projekte dhe aktivitete të cilat kanë në fokus përmirësimin e shëndetit. Gjithashtu, në Klubin tonë të Shëndetit, njerëz të shumtë kryejnë vazhdimisht ekzaminime të gjendjes shëndetësore dhe teste fitnes të cilat ofrohen vetëm në Klubin e Shëndetit SIGAL.

SIGAL UNIQA është partner i universiteteve publike dhe private në vend duke marrë pjesë aktivisht në panairet e punës dhe seminare të ndryshme si dhe përmes ofrimit të praktikave mësimore në zyrat qendrore. Panairet e punës të zhvilluara nga universitete të ndryshme kanë qenë në fakt prezantimi i parë me disa të rinj të cilët tashmë janë pjesë e stafit SIGAL UNIQA.

Ne besojmë thellësisht tek vlerat kulturore dhe trashëgimia e vendit tonë. Në këtë kuadër, në vitin 2012 restauruam një prej shtëpive tradicionale në lagjen Mangalem, Berat, aset i SIGAL UNIQA. Tashmë të kthyera në identitetin dhe imazhin që meritojnë, këto ndërtesa tipike janë përfshirë sërish në listën e atraksioneve kulturore që ofrojnë këto qendra të rëndësishme të turizmit shqiptar.

Kompania e Sigurimeve "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i automjeteve TPL dhe TPL+
- Sigurimi i shendetit ne udhetim
- Sigurimi i parave ne kasaforte dhe gjate transportit (CIS & CIT)
- Sigurime zjarri dhe rreziqet shtese
- Sigurimi nga te gjitha rreziqet ne ndertim (CAR)
- Sigurimi KASKO
- Sigurimi ndaj aksidenteve personale
- Sigurimi daj aksidenteve personale
- Sigurimi i garancionit
- Sigurimi i pergjegjesise – demshperblim profesional
- Sigurimi i pergjegjesise – publike
- Sigurimi i pergjegjesise – se produktit
- Sigurimi shendetesor
- Mbulimi plus
- Sigurimi bujqesor dhe i blegtorise
- Sigurimi i Mallit ne transport

Sigma

Interalbanian Vienna Insurance Group

Telefoni: 038 246 301 **email: info@sigma-ks.net**
www.sigma-ks.net

SIGMA SH.A është kompania e parë private e sigurimeve në Shqipëri, e themeluar në vitin 1998 në Tiranë.

Në gusht të vitit 2001, vetëm 3 vjet pas themelimit të saj, SIGMA ka hyrë në tregun e Kosovës në bashkëpunim me nje kompani lokale.

Ne tetor 2002, SIGMA hyn në tregun e sigurimeve te Maqedonise dhe ka filluar funksionimin aktiv në vitin 2003

Në shtator të vitit 2004, SIGMA ka marrë licencën për të operuar në Kosovë përmes Deges se saj Sigma sh.a – Dega Kosove.

Ne Shtator te vitit 2007 Sigma u bë anëtare e Vienna Insurance Group me blerjen e 75% plus 1 aksion të kapitalit te SIGMA-s nga TBIH – Shërbimet Financiare grup N.V në të cilën Vienna Insurance Group ka shumicën e aksioneve.

Në dhjetor 2008 Vienna Insurance Group blen shumicen e aksioneve te kapitalit te SIGMA-S në vlerë prej 87 për qind plus 1 aksion.

Në maj të vitit 2009 Vienna Insurance Group bleu 100% të aksioneve të SIGMA-s në Republiken e Maqedonise. Sipas strategjisë së saj për riemërtim dhe riorganizimin, nga data 20.10.2009 emri i ri shfaqet në tregun e sigurimeve në Maqedoni -WINNER, pjesë e një familje të madhe e Vienna Insurance Group

Në janar 2015 u zyrtarizua bashkimi i SIGMA-s me kompaninë bashkë-motër Interalbanian, si rezultat kompania e re SIGMA Interalbanian Vienna Insurance Group ka një kapital me të fortë, një rrjet të shitjes me të gjerë, një shkrirje më të mirë te ekspertizës për produkte të njohura, por edhe të veçanta në treg.

Nga pikëpamja organizative, SIGMA Interalbanian Vienna Insurance Group operon në tregun e brendshëm në një shtrirje të madhe gjeografike duke ofruar shërbimet e saj ne te gjithe territorin e Kosoves.

Që prej shumë vitesh ne jemi nje nga Kompanite Lidere ne Treg bazuar ne volumin e primeve te realizuara per te gjitha linjat e bizneseve dhe Lider per sigurimet vullnetare per vitin 2014 – 2015. SIGMA Interalbanian Vienna Insurance Group është një kompani e cila gëzon reputacion shumë të mire reflektuar në marzhin e lartë të rinovimeve të kontratave me Klientet si dhe vlerësimit të aktivitetit të saj nga Institucionet mbikëqyrëse.

Si nje Kompani qe e ushtron aktivitetin e saj me standarte te larta te mbeshtetura edhe nga Kompania meme Vienna Insurance Group dhe partneret risigurues, Sigma Interalbanian Vienna Insurance group sh.a jep kontributin maksimal drejt plotesimit te kushteve për zhvillimin dhe konsolidimin e tregut lokal të sigurimeve.

PROFILI I KOMPANISË

Imazhi dhe kapaciteti që kompania ka në treg ka qenë rezultat i depërtimit efikas në segmente të ndryshme të tilla si individë, organizata jofitimprurëse, institucione të huaja të akredituara, kompani të mëdha, në kompani të ndryshme industriale, institucione financiare, etj Kjo është arritur ne saje te nje stafi profesional, te talentuar dhe energjik; mbeshtetjes se kompanise sone meme Vienna Insurance Group dhe bashkepunimit korrekt dhe të sukseshëm me partneret lokale dhe ndërkombëtarë.

Kompania e Sigurimeve "Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë
- Sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë
- Sigurimi i Pronës nga të gjitha Rreziqet
- Sigurimi nga vjedhja
- Sigurimi i mallit ne transport (cargo)
- Sigurimi i Parave në Kasafortë dhe në Udhëtim
- Sigurimi nga të gjitha Rreziqet në ndërtim (CAR/EAR)
- Sigurimi i vetë mjetit motorik (KASKO)
- Sigurimi i Ofertës dhe Kontratës
- Sigurimet e Pergjegjësisë
- Sigurimi shendetësor
- Sigurimi shëndetësor i pergjithshëm
- Sigurimi i shëndetit në udhetim
- Sigurimi nga aksidentet personale
- Sigurimi BBB& ECC

BIE 9.3%
NUMRI I
AKSIDENTEVE
ME PASOJA FATALE

Gjatë periudhës janar-tetor 2022 ka rënë në 9,3 për qind numri i aksidenteve me pasoja fatale, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku ka thënë se shpëtimi i vetëm një jete të njeriut përmes kampanjave të vetëdijesuese të BKS-së është një sukses i madh për të. Për rezultatet e arritura drejtori i Byrosë falënderon Policinë e Kosovës për angazhimin maksimal që ata kanë pasur gjatë këtij viti.

17.324
aksidente komunikacioni kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2022.

17.517
aksidente komunikacioni kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2021

193
aksidente më pak kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

1.10%
ka rënë numri i aksidenteve në Kosovës gjatë periudhës janar-tetor 2022 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

78
aksidente me pasoja fatale kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2022.

86
aksidente me pasoja fatale kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2021.

8
aksidente më pak me pasoja fatale kanë ndodhur gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

9.30%
është më i vogël numri i aksidenteve me pasoja fatale gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

88
persona kanë vdekur në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2022.

97
persona kanë vdekur në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2021.

9
persona më pak kanë humbur jetën në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

9.28%
është më i vogël numri i qytetareve që kanë humbur jetën në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

10,755
aksidente më dëme kanë ndodhur gjatë periudhës janar-tetor 2022 në vendin tonë.

11.172
aksidente më dëme kanë ndodhur gjatë periudhës janar-tetor 2021 në vendin tonë

471
aksidente me dëme kanë ndodhur më pak gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

3.73%
ka rënë numri i aksidenteve më dëme gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

6,491
aksidente me lëndime kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2022.

6,259
aksidente me lëndime kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-tetor 2021.

232
aksidente me lëndime kanë ndodhur më shumë gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

3.71%
është rritur numri i aksidenteve më lëndime gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

12,354
persona janë lënduar në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2022.

12,354
persona janë lënduar në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2021.

240
persona janë lënduar më shumë në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2022 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

1.98%
është më i lartë numri i personave të lënduar në aksidente komunikacioni gjatë periudhës janar-tetor 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

dukagjini · EUROSIG · ELSIG · SIGURIA · ILLYRIA · SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA · SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP · SCARDIAN · PRISIG · SIGKOS

Mazreku vazhdon lobimin për anëtarësim në Byronë e Kartonit të Gjelbër

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) Sami Mazreku, së bashku me drejtorin Financiar të BKS-së Valon Berisha, të enjten në Athinë kanë takuar Tassos Paginos, kryesues i Byrosë Greke të Sigurimeve, si dhe Elina Papaspyropoulou drejtoreshë e Asosacionit të Sigurimeve në Greqi, ku më ta kanë biseduar rreth përkrahjes së Greqisë për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër. Pas takimit Mazreku ka vlerësuar lart përkrahjen nga autoritetet Greke dhe gjithashtu ai ka paralajmëruar së shumë shpejt Byroja Kosovare e Sigurimit do ta gjej mundësinë për anëtarësimin e Kosovës në Byronë e kartonit të Gjelbër. Para pak ditësh gjatë shënimit të 11 vjetorit të BKS-së presidentja dhe drejtoresha e Byrosë së Kartonit të Gjelbër kanë konfirmuar se në aspektin teknik BKS-ja tashmë ka plotësu-

ar të gjitha kriteret për anëtarësim. Përndryshe drejtori Mazreku është duke zhvilluar takime të vazhdueshme me drejtues të Byrove për të marrë nga ta përkrahje në arritjen e qëllimit, pra anëtarësimit të Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjelbër.

Rexhepi siguron Mazrekun se qeveria do ta mbështesë në vazhdimësi

Zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilja Rexhepi, ka pritur sot drejtorin e Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazrekun. Drejtori Mazreku e ka njoftuar zëvendëskryeministren për të arriturat në BKS, të cilat janë pasqyruar edhe në Raportin e Progresit. Gjithashtu, Mazreku ka njoftuar zëvendëskryeministren edhe për veprimet që do të ndërmarrë BKS-ja për të ndikuar në rritjen e lëvizjes së lirë të qytetareve të Kosovës në shtete të rajonit, por edhe më gjerë. Zëvendëskryeministrja e ka falënderuar drejtorin Mazreku për të arriturat e BKS-së të cilat edhe janë prezantuar për herë të parë në raportin e Progresit për Kosovën. Ajo gjithashtu i ka ofruar përkrahje drejtorit Mazreku si dhe ka kërkuar nga ky Intensifikimin e punëve për arritjen e marrëveshjes për njohje të policave të sigurimit me Bosnjen dhe Hercegovinën. Në fund të takimit zëvendëskryeministrja Rexhepi e ka siguruar Mazrekun se do ta ketë mbështetjen e vazhdueshme te Qeverise

Trajnim për mbrojtjen e të dhënave personale

Komisionin Evropian, njëri ndër institucionet më të larta të Bashkimit Evropian, ka publikuar raportin për Kosovën për vitin 2022, i cili po ashtu sot iu dorëzua edhe liderëve më të lartë shtetëror. Ky raport vlerëson të arriturat e Kosovës në të gjitha fushat, përfshirë edhe arritjet në fushën e ekonomisë. Një pjesë e raportit flet edhe për sektorin e sigurimeve, i cili dy vitet e fundit ka pasur zhvillim të mëdha, duke bërë që ky sektor vital të kthehet në binar. “Performanca e sektorit të sigurimeve mbeti pozitive në 2021, me fitim neto të rritjes me 50% me bazë vjetore”, thuhet në faqen 65 të raportit të KE-së. Po ashtu Komisioni Evropian vlerëson pozitivisht edhe bashkëpunimin që ka Kosova me vendet e rajonit. “Kosova ka marrëdhënie të mira me Malin e Zi. Në qershor 2021, Kosova dhe Mali i Zi nënshkruan një marrëveshje për heqjen e taksës së sigurimit të automjeteve për hyrjen në territoret e tyre përkatëse. Kosova vazhdon të ketë marrëdhënie të mira në përgjithësi me Maqedoninë e Veriut”, thuhet në faqen 78 të raportit të Komisionit Evropian. Ndryshe, Komisioni Evropian në raportin e sotëm të progresit, përsërit qëndrimin e mëparshëm, se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave, ndërsa kërkohet që Këshilli i BE-së të merret me urgjencë me këtë çështje.

Trajnim për mbrojtjen e të dhënave personale

Zyrtarët e Kompanive të Sigurimeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve u trajnuan nga Agjencia për Informim dhe Privatësi lidhur me Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjencia për Informim dhe Privatësi, në kuadër të ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe private ka mbajtur trajnim me zyrtarët përgjegjës të kompanisë së sigurimeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimeve lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale.

Disa nga temat kryesore që janë trajtuar gjatë trajnimit janë:

Parimet e përpunimit të të dhënave personale,

Roli dhe detyrat e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale,

Siguria e të dhënave personale etj.

Vlen të theksohet se nga pjesëmarrësit u shfaq një interesim i shtuar duke bërë pyetje dhe hapur diskutime lidhur me raste të ndryshme. Zyrtarët nga Agjencia për Informim dhe Privatësi shprehën gatishmërinë e tyre për vazhdimin e mbajtjes së trajnimeve, si dhe ofrimin e këshillave e opinioneve kurdoherë që ju kërkohet.

dukagjini · EUROSIG · ELSIG · SIGURIA · ILLYRIA · SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA · SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP · SCARDIAN · PRISIG · SIGKOS

Scardian

Telefoni: 049 / 909 090
049 / 777-444
email: info@scardian.com
www.scardian.com

Scardian Sigurime, ashtu siç tregon simboli ynë, është kompani e besueshme, mbrojtëse, e kujdesshme dhe e përkushtuar ndaj atyre që na mundëson ekzistencën, pra klientëve tanë.

Ju ofrojmë shërbime, që janë gjithmonë një hap përpara industrisë së sigurimeve në treg, duke gjetur zgjidhje të reja dhe të volitshme sigurimesh. Jemi të vetmit, që ofrojmë sigurimin Kasko, pavarësisht vlerës dhe vitit të prodhimit të veturës, jemi të vetmit që ofrojmë sigurimin shtëpiak, pavarësisht madhësisë së shtëpisë, jemi të vetmit që ofrojmë shitjen online të Sigurimeve KASKO, të Pronës dhe të Shëndetit në Udhëtim, dhe jemi të vetmit që ju bëjmë ofertën e sigurimit brenda 5 minutash.

Produktet tona ofrojnë sigurim dhe kompensime që klientëve tanë u nevojiten realisht dhe kjo me çmime shumë të arsyeshme.

Qëllim yni është të minimizojmë traumat dhe shpenzimet e klientëve tanë në rast të fatkeqësive. Mundohemi që t`u ndihmojmë klientëve të vazhdojnë përditshmërinë sa më shpejt pas ndodhjes së fatkeqësive.

SCARDIAN Sigurime ju ofron mundësi të ndryshme për të mbrojtur çdo aspekt të biznesit tuaj, duke filluar nga lëndimi i punëtorëve e deri tek katastrofat natyrore.

Edhe në udhëtimet e planifikuara me kujdes,

mund të ndodhin gjëra të paparashikuara. Sigurojini vetes dhe familjes kujdes shëndetësor të mirë në rast të sëmundjeve, ose aksidentit gjatë udhëtimeve jashtë Kosovës.

Me një policë të shëndetit në udhëtim, Scardian, jua kompenson shpenzimet që mund të rezultojnë për shërim apo hospitalizim emergjent gjatë qëndrimit tuaj në ndonjë shtet të huaj.

Pos heqjes së shpenzimeve mjekësore, Scardian nëpërmjet kompanisë partnere CORIS International, ju ofron asistencë dhe informata 24/7 rreth shërbimeve mjekësore në shtetin ku gjendeni dhe kontakton me spitalin në rast të shtrirjes.

Sigurimi i shtëpisë dhe pronës

Scardian, do t'ju kompensojë për dëmet, që ndodhin nga rreziqet si: zjarri, rrufeja, eksplodimi, goditja e mjetit motorik, rënia e drunjve, stuhia dhe rreziqe të tjera.

Në rast të vjedhjes së pajisjeve të siguruara, Scardian, i kompenson ato deri në shumën e siguruar.

Nëse dikush pëson aksident dhe lëndohet brenda shtëpisë suaj, qoftë familjar, apo mysafir, Scardian, merr përsipër shpenzimet mjekësore për trajtimin e tyre.

Edhe veturat më të vjetra ia vlenë të sigurohen Kasko. Tani çdo veturë mund ta siguroni Kasko pavarësisht vlerës apo vitit të prodhimit.

Zgjedhni opcionin Kasko në Evropë dhe polica juaj do të vlejë në tërë Unionin Evropian.

Siguroni edhe vetën tuaj, pasi që me të gjitha sigurimet e veturës që i keni, ju jeni të vetmit që nuk jeni të siguruar.

Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i Autopërgjegjësisë
- Sigurimi i Autopërgjegjësisë
- Sigurimi TPL Kosova Plus
- Sigurimi i Automjetit Kasko
- Sigurimi i punetorëve nga Aksidentet Personale
- Sigurimi i Garancive
- Garancia e Ofertës
- Garancia e Kontratës
- Garancia e Ruajtjes/Mbajtjes
- Garancia e Avansit
- Sigurimi i Pronës nga Zjarri dhe Rreziqet Shtesë
- Sigurimi i Përgjegjësive
- Përgjegjësia e Përgjithshme
- Përgjegjësia Publike
- Përgjegjësia e Produktit
- Përgjegjësia Profesionale
- Sigurimi i Parave në Kasafortë dhe në Udhëtim – CIS & CIT
- Sigurimi i Mallërave gjatë Transportit - Kargo
- Sigurimi CAR & EAR

Illyria

Telefoni: 038 750 850 **email: info@illyriainsurance.com**
www.illyriainsurance.com

Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” sh.a. është pjesë e grupit Sava Re, me seli në Lubjanë, Republika e Sllovenisë, grupit më profesional për sigurime dhe risigurime në regjion e cila njëherit njihet si njëra ndër kompanitë më të suksesshme në Europë.

Të gatshëm për të ofruar mbështetje në përmbushjen e nevojave siguruese në çdo kohë dhe vend si: shëndetin, familjen, shtëpinë, apo dhe mjetin tuaj motorik. Produket tona siguruese personale dhe ato komerciale janë të përshtatura dhe dizajnuara për t’i ofruar paqe mendjes së klientit.

Misioni ynë:

Të ofrojmë stabilitet financiar dhe të ardhme të sigurtë.

Ne synojmë një kulturë të re dhe më ndryshe në tregun e sigurimeve, me një ekip punonjësish që do të reflektojë pozitivisht me kualitet të shërbimit dhe besnikëri ndaj kompanisë dhe Grupit SAVA Re.

Kompania e Sigurimeve “Illyria” sh.a. njihet në tregun e Republikës së Kosovës si kompania me shërbimin më kualitativ të mundshëm në industrinë e sigurimeve. Këtë shërbim e ofrojmë përmes pakos së plotë të produkteve për klientët, të cilët mund të zgjedhin ofertën me nivelin optimal financiar dhe duke e bazuar atë në kërkesat e tyre specifike.

Përgjegjësia ndaj shoqërisë

Ne ndërtojmë marrëdhënie afatgjatë miqësore dhe jemi të përgjegjëshëm ndaj mjedisit dhe shoqërisë.

Sigurimet konsiderohen pjesë e zhvillimit ekonomik, apo pjesë e riskut ekonomik dhe kjo tregon se industria e sigurimeve është e lidhur ngushtë me mjedisin e gjërë ekonomik.

Andaj, brenda këtij sistemi, jemi përgjegjës të përkrahim aktivitetet të cilat ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit shoqëror, ashtu që çdo anëtar brenda Kompanisë së Sigurimeve “Illyria” sh.a. duhet të tregojë gatishmëri të ndihmojë aktivitete të tilla në nivel lokal dhe më gjërë.

Udhëtoni të sigurtë!

Udhëtimet shpesh janë të sigurta, por ndonjëherë mund të jenë të paparishkueshme. Pa marrë parasysh se a udhëtoni me veturë, avion apo metoda tjera transporti, gjithmonë është e këshillueshme të keni bërë sigurimin e shëndetit në udhëtim.

Problemet e mundshme që dalin kur udhëtoni jashtë vendit janë shpesh më të ndërlikuara për t'u zgjidhur. Njerëzit ju flasin një gjuhë të huaj dhe nganjëherë është e vështirë të merrni informacionin e duhur, dhe kostot e papritura siç janë shpenzimet e mjekut, mund të jenë të mëdha. sigurimi-shendetit-udhetim-illyria

Kudo që të vendosni të udhëtoni në botë, nga Gjermania, Italia, Azia në SHBA, sigurimi shëndetësor i udhëtimit Kompania e Sigurimeve "Illyria" sh.a mbulon të gjithë botën, pra çdo gjë jashtë kufijve të Republikës së Kosovës. Kontraktimi i sigurimit të udhëtimit është një vendim i rëndësishëm që mund të shpaguhet shumë herë.

Kompania e Sigurimeve "Illyria"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i Atomjetit
- Sigurimi i Automjetit Kasko
- Sigurimi i Aksidenteve Personale
- Sigurimi i Pronës nga Zjarri
- Sigurimi i shëndetit
- Sigurimi i biznesit

PRISIG

Telefoni: 038 / 221-000 email: info@prisig-ks.com
www.prisig-ks.com

Ne jemi zgjidhja ideale e sigurimeve sepse njohim rëndësinë dhe kërkesat e njerëzve përsigurime.

PRISIG ofron produkte dhe shërbime të nivelit të lartë, me standard ndërkombëtar dhe shërbime korrekte ndaj kërkesave të të siguruarve.

PRISIG shërben si furnizues me produkte të sigurimeve dhe si mbështetje financiare për të dëmtuarit, njëkohësisht duke qenë një kompani stabile. PRISIG po rritet fuqishëm me shitjen e produkteve të reja tek klientët e ekzistues. Njëkohësisht synon klientët e rinj me garancionin që të jemi krah i fortë i tyre në të papriturat e jetës. Për krejt këto e kemi zgjedhur rrugën e komunikimit inteligjent dhe me vetëm dy klikime do të jemi pranë jush.

Me vetëm dy klikime në aparatin tuaj në www.prisig-ks.com ju bleni mbulesën tuaj siguruese,paraqitni të gjitha dëmet, dhe jeni të informuar për secilin hap deri në realizimin e të drejtëstuaj për dëmshpërblim.

Në mënyrë që shërbimet të jenë në nivelin më të lartë janë angazhuar ekspertë tëshkëlqyeshëm të këtyre qështjeve.

PRISIG ka rrjet të dendur të pikave të veta në krejt Kosovën me personel të zgjedhur, shumëtë përkushtuar e me përvojë të gjatë, të cilët njihen aq mirë nga klientët tonë.

PRISIG posedon infrastrukturën më moderne të IT-së, që efikasiteti të jetë në nivelin më të lartë.

PRISIG ofron produkte të dizajnuara veçanërisht për nevojat e klientëve, në mënyrë që ata tandjejnë se janë të rëndësishëm dhe të respektuar.

Kualiteti dhe serioziteti në punë, shërbimet e shpejta e korrekte, dhe pagesat efikase edëmeve janë standard i punës së Kompanisë tonë.

PRISIG është kompani serioze, efikase, me vizion të ri dhe të qartë, që u përgjigjet dhe i

përvetëson standardet më të reja dhe më cilësore, që janë model për tregun vendor e rajonal.

Sigurimi i automjetit

Vlerat tona pasqyrojnë mënyrën se si ne i përmbushim kërkesat e klientëve tanë me

përgjegjësi e profesionalizëm të lartë.

Krijoni vetës rahati të mendjes duke ditur se automjeti juaj është i siguruar.

Shumë prej nesh kanë nevojë për automjete për të mundësuar lëvizjen nga një vend në tjetrin, kështu që të gjithë e dimë se sa mund të jenë të dobishëm në njërën anë por edhe sa e rrezikshme mund të jetë ngasja në anën tjetër. Ju mund të jeni të kujdesshëm dhe t'i bindeni rregullave të trafikut, por dikush tjeter mund të jetë shkaku i një aksidenti që ju përfshin.

Kompania e Sigurimeve "Prisig"ofron një portfolio të ndryshëm të produkteve të sigurimeve sikurse janë:

- Sigurimi i automjetit - TPL
- TPL+
- Kasko
- Biznes
- Shtëpi
- Banesë
- Shëndet
- Udhëtim
- Aksident
- Lejeqëndrim
- Tender
- Ekzekutim/Mirëmbajtje
- Doganore/Avans

dukagjini insurance company | EUROSIG KOMPANI SIGURIMESH Sigurí e standardeve europiane. | ELSIG | SIGURIA | ILLYRIA Kompania e Sigurimeve, sh.a. Anëtare e Grupit Sava Re | SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA | SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP | SCARDIAN | PRISIG KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY | SIGKOS KOMPANIA E SIGURIMEVE INSURANCE COMPANY

Drejtorët e kompanive mbështetën reformat në BKS-së

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) thotë se gjatë dy viteve të fundit ka pasur një progres të theksuar në trajtimin me kohë dhe pagesën në kohë të dëmeve të raportuara, që sipas tij është si rezultat i një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm mes kompanive dhe BKS-së, pasi që kompanitë në vazhdimësi paguajnë mjete për fondin e kompensimit pa asnjë hezitim.

iSIGURIME

Drejtorët e kompanive të sigurimeve kanë mbështetur në tersi reformat në Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS). Këto komente i ka bërë drejtori i BKS-së Sami Mazreku në prag të mbylljes së suksesshme të vitit 2022. Sipas tij, gjatë dy viteve të fundit ka pasur një progres të theksuar në trajtimin me kohë dhe pagesën në kohë të dëmeve të raportuara. Sipas tij kjo është si rezultat i një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm në mes të kompanive dhe BKS-së, pasi që kompanitë në vazhdimësi paguajnë mjete për fondin e kompensimit pa asnjë hezitim.

"Nga ardhja ime në krye të Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë, por edhe Banka Qendrore e Kosovës, tashmë kanë qasje krejtësisht tjetër. Pra, duke nisur nga guvernatori, duke vazhduar të secila kompani, ka një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Byronë Kosovare të Sigurimit. Për këtë unë kam një falënderim të veçantë për secilin drejtor. Byroja Kosovare e Sigurimit gjatë dy viteve të fundit ka pasur një progres të theksuar në trajtimin në kohë dhe pagesën në kohë të dëmeve të raportuara, e që edhe kjo është si rezultat i një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm mes kompanive dhe BKS-së, pasi që kompanitë në vazhdimësi paguajnë mjete për fondin e kompensimit pa asnjë hezitim", ka thënë drejtori Mazreku.

ME PËRKRAHJEN E TYRE NDRYSHUAM IMAZHIN E BKS-SË

Më tutje drejtori i BKS-së Sami Mazreku tregon se në bashkëpunim me drejtoret e kompanive në masë të madhe kanë punuar në ndryshimin e imazhit të BKS-së.

"Pra, përveç pagesës së dëmeve gjatë kësaj periudhe kohore, ne kemi punuar shumë në ndryshimin e imazhit të BKS-së, dhe mendoj se në këtë drejtim kemi arritur rezultate të dukshme. Në këtë drejtim asnjëherë nuk ka munguar përkrahja e drejtoreve të kompanive të sigurimit, të cilët gjithmonë janë të gatshëm për të mbështetur iniciativa që ndryshojnë dhe reformojnë sektorin e sigurimeve në vendin tonë. Pra, sot falë mbështetjes pa rezerve të guvernatorit Mehmeti, bashkëpunimit të drejtoreve të kompanive të sigurimit, sektori i sigurimeve në vendin tonë tashmë është krejtësisht tjetër sikurse në vende të rajonit, por edhe më larg", ka thënë më tutje drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit Sami Mazreku.

RRITJA E TREGUT VULLNETAR

Drejtori Mazreku më tutje tregon se falë angazhimit të madh të drejtoreve të kompanive të sigurimit, tregu i sigurimeve në Kosovë është duke u zhvilluar nga ditë në ditë. Sipas tij, rritja e tregut vullnetar tregon qartë për një rritje dhe zhvillim të tregut të sigurimeve në vendin tonë. "Bazuar në të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se tregu vullnetar me atë obligativ thuajse është barazuar. Kjo po ndodh për shkak të zhvillimit të tregut, rritjes se ofertës nga ana e kompanive të sigurimit", ka thënë më tutje Mazreku. Sipas tij, tashmë kompanitë e sigurimeve në vendin tonë janë të njëjta sikurse me ato nëpër shtete të zhvilluara evropiane, por edhe më larg.

Byroja Kosovare e Sigurimit gjatë dy viteve të fundit ka pasur një progres të theksuar në trajtimin në kohë dhe pagesën në kohë të dëmeve të raportuara, e që edhe kjo është si rezultat i një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm mes kompanive dhe BKS-së, pasi që kompanitë në vazhdimësi paguajnë mjete për fondin e kompensimit pa asnjë hezitim", ka thënë drejtori Mazreku.

dukagjini insurance company | EUROSIG KOMPANI SIGURIMESH Sigurí e standardeve europiane. | ELSIG | SIGURIA | ILLYRIA Kompania e Sigurimeve, sh.a. Anëtare e Grupit Sava Re | SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA | SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP | SCARDIAN | PRISIG KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY | SIGKOS KOMPANIA E SIGURIMEVE INSURANCE COMPANY

SIGURIMET NË NUMRA

10,759,869€
është rritur volumi i primeve të shkruara bruto gjatë periudhës janar-shtator 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

12.3%
është rritur tregu i sigurimeve gjatë periudhës janar-shtator 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

98,292,043€
ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto, në fund të muajit shtator të këtij viti.

13,121
dëme më shumë janë paguar gjatë periudhës janar-shtator 2022, sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

1,010,716
ka arritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit shtator të këtij viti.

10.9%
është rritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetarët në fund të muajit shtator të këtij viti, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

109,648
dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve, por edhe nga Byroja Kosovare e Sigurimeve, vetëm gjatë periudhës janar-shtator 2022.

93,363,143€
ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit shtator të këtij viti.

10.90%
është rritur vuolimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës, deri në fund të muajit shtator të këtij viti.

4,427,632€
ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës, deri në fund të muajit shtator të këtij viti.

47.30%
është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës deri në fund të muajit shtator të këtij viti, në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

27,458
ka arritur numri i kontratave në sigurimin e jetës, në fund të muajit shtator të këtij viti.

30,13%
është rritur numri i kontratave në sigurimin e jetës gjatë periudhës janar-shtator 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Performanca e sektorit të sigurimeve gjatë periudhës janar-shtator 2022 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak .